

AKT THEMELIMI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“VESA ARCHITECTS”

Sot më datë 25-05-2024, unë e nënshkruara:

- Znj.Saimira Arapi, shtetase shqiptare, e datëlindjes 13.12.1989 lindur në Lushnje dhe banues në Tiranë, Rruga “Ndre Mjeda”, Kompleksi Alba. Ap.182, person madhor me zotësi juridike për të vepruar, mbajtëse e letërnjoftimit me nr.032929734 dhe nr.personal I96213080S

Neni 1
Emërtimi

Shoqëria emërtohet **“VESA ARCHITECTS” SH.P.K.**

Neni 2
Selia

Selia zyrtare e shoqërisë ndodhet në Tiranë, Rruga “Muhedin Llagani”, Kompleksi SQ21, AP.171

Neni 3
Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e aktivitetit të shoqërise do të jetë pa afat, duke filluar prej datës së regjistrimit të saj në Regjistrin e Shoqërive Tregtare pranë Qëndrës Kombëtare të Biznesit (QKB). Ky afat mund të ndryshohet një ose më shumë herë, me vendim të Asamblesë së Ortakeve.

Neni 4
Objekti i veprimtarisë

Projektim arkitetonik dhe konstruktiv për objekte civile, industriale, turistike, bujqësore etj.

Projektim dhe zbatim interieri. Projekte elektrike dhe hidro-mekanike. Projekte telekomunikacioni. Projekte infrastrukturë. Projekte të peisazhit dhe sistemimit. Projekte restaturimi për objekte të tipologjive të ndryshme. Supervizim punimesh, hartim të raporteve të supervizimit dhe akt kolaudimit për ndërtesa të tipologjive të ndryshme. Studime e projekteve hidro-gjeologjike, gjeologjike dhe fizmijologjike. Projektim topografik, hartografik dhe fotogrametrik. Studime, planifikime, vlerësimi, studime fizibiliteti dhe projekte urbanistike.

Vlerësim i pasurive të paluajtshme. Hartim i projekteve të eficencës dhe auditimi i energjisë së ndërtesave civile dhe industriale. Hartim i akt-eskpertizave për gjykatat e shkallëve të ndryshme, në



fushën e projektimit dhe ndërtimit, si dhe bazave hartografike të pasurive të paluajtshme etj. Konsulenca teknike dhe juridike për shërbimet e mësipërme.

Tregëtim mallrash brënda dhe jashtë vendit;

Shoqëria mund të ndërmarrë dhe zhvilloje çdo lloj aktiviteti tjetër të lejuar nga ligji vetëm ose në bashkëpunim me pale të treta nëpërmjet nënkontraktimit, qoftë ky aktivitet tregtar, juridic, finançiar, promocional, etj që e vlerësin të dobishme ose të nevojshme për arritjen e qëllimeve të saj.

Neni 5
Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100.000 (njëqindmijë) lëkë.

Kapitali themeltar është i përbërë nga 1 (një) kuotë.

Znj. Saimira Arapi zotëron 1 (një) kuotë me vlerë 100.000 (njëqindmijë) leke.

Neni 6
Kuotat e Kapitalit themeltar

Derdhja e kapitalit themeltar është bërë në masën dhe mënyrën e mëposhtme:

- Znj. Saimira Arapi ka kontribuar në para në shumën 100.000 (njëqindmijë) lekë.

Pjesëmarrja në kapitalin themeltar të shoqërisë është në perputhje me kontributin si me poshtë:

- Znj. Saimira Arapi është zotëruese e 1 (një) kuotë kapitali me vlerë 100.000 (njëqindmijë) leke ose 100% të kapitalit themeltar të shoqërisë

Neni 7
Kuotat dhe kalimi i kuotave të kapitalit

Zotërimi i kuotave, mënyrat e fitimit dhe kalimit të kuotave, pjesëtimi dhe transferimi i tyre do të behen sipas procedurave të parashikuara ne ligjin Nr.9901. datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar dhe nga statuti i shoqërisë.

Neni 8
Administrimi

Shoqëria administrohet nga një ose disa administrator persona fizik, qofshin këta edhe jo ortak të cilët emërohen ose shkarkohen nga Asambleja e përgjithshme. Administraori/ët qëndrojnë ne postin e tyre për pesë vjet finançiarë, me mundësi për t'u rizgjedhur. Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në të gjitha rrëthanat që kanë lidhje me objektin e shoqërisë, me përfashtim të kompetencave që ligji apo statuti i jep Asamblesë duke përfshirë delegimin e kompetencave dhe personave të tjere me prokure të posaçme.



A handwritten signature in blue ink, appearing to read 'Saimira Arapi' followed by the number '24' at the end.

Administratori i shoqërisë është:

- Znj. Saimira Arapi, shtetase Shqiptare, e datëlindjes 13-12-1989 lindur ne Lushnje, banues në Tirane, rruga "Ndre Mjeda", Kompleksi Alba, Ap.182, person madhor me zotësi juridike për të vepruar, mbajtëse e letërnjoftimit me nr.032929734 dhe nr.personal I96213080S.

Administratori do të ndjeki të gjitha procedurat e nevojshme për regjistrimin e shoqërisë në Qëndrën Kombëtare të Biznesit (QKB). Të gjitha shpenzimet që do të kryen deri në regjistrimin e shoqërisë si person juridik do të përfshihen në bilancin e shoqërisë.

Neni 9
Të tjera

Shoqëria do ta ushtroj aktivitetin e saj sipas legjislacionit shqiptar. Kushtet e punës, shpërblimet, oraret, pushimet dhe sigurimet shoqërore të personelit dhe do të rregullohen me kontrata kolektive ose ajo individuale e punës, si dhe nga legjislacioni shqiptar në fuqi.

Neni 10
Kundërshtimet

Të gjithë kundërshtimet ose mosmarrveshjet që mund të lindin gjatë funksionimit të shoqërisë ose gjatë likujdimit të saj midis ortakëve ose një ose me shumë ortakeve dhe shoqërisë do të diskutohen në mënyrë të drejtperdrejtë midis të intëresuarve për ti zgjidhur miqësisht. Ne rast të kundërt I nënshtrohen juridiksonit të gjykatave kompetente në kushtet e parashikuara nga legjislacioni Shqiptar në fuqi.

Neni 11

Ky Akt themelimi është përgatitur në katër kopje të barazvlefshme në gjuhën shqipe.

ORTAKU I VETËM I SHOQËRISË "VESA ARCHITECTS" SH.P.K.

SAIMIRA ARAPI

Saimira Arapi
J.P.24